

LIGA UNIKE | SHQIPËRI-KOSOVË



**LIGA
UNIKE**

**STATUTI
LIGA UNIKE**

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Forma e Organizimit

- 1.1 “Liga UNIKE” (në tekstin e mëtejme Liga) është organizatë shoqërore sportive me anëtarësi, e pavarur, jo politike dhe jo ekonomike, jashtë partive politike dhe nuk ndjek qëllime fitimi.
- 1.2 Veprimtaria e “Liga Unike” zhvillohet në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj, Rregulloren dhe Statutin e FIBA-s, ligjin nr. Nr. 04/L-57 datë. 09.09.2011 të Republikës së Kosovës “Për lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare”.

Neni 2

Emri dhe simboli

2.1 Emri i organizatës është: “Liga UNIKE”.

Ky emër do të figurojë në të gjitha shkresat dhe korrespondencën që del nga Liga.

2.2 Logoja e “Liga Unike” është “Mburoja Ilire”, e cila simbolizon fuqinë, unitetin dhe targetin e ligës së përbashkët të basketbollit, Shqipëri-Kosovë.

2.3 **Vula e “Liga Unike”** do të përmbajë emrin zyrtar, shkurtesën, adresën dhe logon.

Neni 3

Selia dhe vendi i zhvillimit të aktivitetit

- 3.1 Selia e “Liga UNIKE” ndodhet në: Lagja Arbëria, Blloku C3 (Faza 2), Rr. Radovan Zogoviq, Hyrja 7, 10000 Prishtinë, Kosovë, me numër telefoni +383 48 703 666 me email adresë info@ligaunike.com
- 3.2 Liga Unike e zhvillon veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.
- 3.3 Sipas marrëveshjeve dhe partneriteteve, aktiviteti i saj do të shtrihet edhe në të gjitha vendet e tjera të rajonit dhe më gjerë.

Neni 4

Kohëzgjatja

4.1 Liga Unike do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat kohor të papërcaktuar.

4.2 Me vendim të Bordit Drejtues mund të shpërndahet, kur kanë votuar më shumë se gjysma e anëtarëve të Bordit Drejtues, të cilët paraprakisht e marrim miratimin nga ana e Federatave themeluese të Ligës.

Neni 5 **Qëllimi i përgjithshëm**

5.1 Qëllimi i “Liga Unike”, është:

- a) Liga Unike është krijuar për shkak të nevojave dhe interesimit të madh të klubeve të basketbollit nga Shqipëria dhe Kosova.
- b) Të zhvillojë dhe promovoj aktivitetin e basketbollit në të gjitha format e tij në rajon. Në bashkëpunim dhe në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet federatave të vendeve të rajonit tonë, Statutin dhe Rregulloret e FIBA-s, legjislacionin kosovar dhe ndërkombëtar në fuqi.
- c) Të zgjerojë hartën e aktiviteteve të basketbollit, nëpërmjet partneriteteve dhe bashkëpunimit të federatave të vendeve të rajonit.
- d) Të nxisë garën midis klubeve pjesëmarrëse dhe të sigurojë frymen e fair- play.
- e) Të rrisë nivelin e bashkëpunimit ndërmjet federatave (palë) dhe klubeve të vendeve pjesëmarrëse.
- f) Të evidentojë dhe promovojë sportistët cilësorë të vendeve pjesëmarrëse, që të shërbejnë si modele për brezat e basketbollistëve të rinj.
- g) Të zhvillojë programe edukative dhe kualifikuese për gjyqtarët dhe trajnerët për vendet pjesëmarrëse.

5.2 “Liga Unike” do t’ia arrij qëllimit të saj nëpërmjet:

- a) Partneriteteve, bashkëpunimit dhe krijimit të një rrjeti lidhjesh me Federatat e vendeve që ndodhen në rajon, FIBA-s dhe autoriteteve qendrore dhe vendore në fushën e sportit, personave fizik dhe juridik, si dhe me institucionet publike dhe private në përputhje me Statutin dhe Rregulloret e Ligës Unike, Legjislacionin e Kosovës, legjislacionin e Bashkimit Evropian si dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi.
- b) Krijimit të kushteve të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të basketbollit në formate të ndryshme në nivel rajonal dhe me gjërë.
- c) Sigurimit të mbështetjes ligjore, financiare dhe organizatave për zhvillimin e aktiviteteve të basketbollit duke bashkëpunuar me autoritetet qendrore, lokale, institucione, Federata dhe persona juridik, publik dhe privat, brenda dhe jashtë Shqipërisë e Kosovës.
- d) Krijimit të mundësive të informimit, botimit dhe publikimit të periodikeve, gazetave, revistave, transmetimeve audiovizive në rrugë ajrore, tokësore ose me çdo lloj mënyre tjetër, portaleve on-line dhe rrjeteve sociale, websiteve, si dhe çdo element tjetër të medias virtuale të shkruar që lidhet me marketingun dhe promovimin e basketbollit, talenteve dhe aktiviteteve të tij.

Neni 6 Llojet e aktiviteteve

6.1 Për arritjen e qëllimit të saj, “Liga Unike” do të kryejë kryesisht këto aktivitete:

- a) Organizimin dhe menaxhimin e aktiviteteve të basketbollit për meshkuj dhe femra në rajon sipas marrëveshjeve të nënshkuara dhe partneriteteve të krijuara me federatat e vendeve të rajonit, anëtare të FIBA-s.
- b) Marketing të sponsorëve që i afrohen aktivitetit të Ligës Unike, si dhe produkteve të tyre në funksion të përmbushjes së qëllimeve të Ligës.
- c) Prodhimit të sinjalit televiziv dhe transferimin e të drejtave televizive dhe të drejtës së reklamave ndaj sponsorëve dhe donatorëve të Ligës.
- d) Aktivitete edukative dhe ndërgjegjësuese për zhvillimin dhe promovimin e basketbollit.
- e) Aktivitete trajnuese për forcim kapacitetesh nxitjen e bashkëpunimit.

6.2. Të gjitha të ardhurat të cilat do të përfitohen nga aktivitete të ndryshme që do të organizojë Liga Unike do të përdoren duke u ri-investuar për realizimin e aktiviteteve të tjera në funksion të përmbushjes së qëllimit të shoqatës.

KREU II ANËTARËSIA NË “LIGËN UNIKE”

Neni 7 Anëtarësimi

Anëtarë të Ligës Unike janë:

- a) Themeluesit e Ligës Unike.
- b) Klubet pjesëmarrëse në Ligën Unike në të dyja konkurrencat.
- c) Anëtarësime të reja mund të bëhen mbi bazën e kërkesës me shkrim drejtuar Bordit Drejtues, i cili do të vendos për miratimin ose jo të saj.
- d) Anëtarët duhet të ushtrojnë aktivitetin e tyre duke respektuar dispozitat e këtij Statuti dhe aktet tjera normative të Ligës Unike.

Neni 8 Regjistrimi i anëtarëve

- a) Çdo anëtar i Ligës Unike duhet të figurojë i regjistruar në regjistrin themeltar të saj.
- b) Në regjistrin e anëtarësimit duhet të shënohen data e anëtarësimit, data e largimit si dhe shkaqet e këtij largimi.

**Neni 9
Të drejtat e anëtarit**

9.1 Anëtari i Liga Unike ka këto të drejta:

- a) Të japë mendime dhe të propozojë ide për zhvillimin dhe avancimin e Ligës Unike.
- b) Të njihet me çdo vendim të marrë nga organet drejtuese të Ligës Unike.
- c) Të marrë pjesë në veprimtari të Ligës Unike.

**Neni 10
Detyrat e anëtarëve**

Anëtari i Ligës Unike ka këto detyra:

- a) Të zbatojë Statutin dhe aktet normative të Liga Unike;
- b) Të kontribuojë për prezantimin dhe mbështetjen e programit të Ligës dhe aktivitetit të saj;
- c) Të kontribuojë për organizimin e veprimtarive dhe aktiviteteve të Ligës;
- d) Të zbatojë detyrat e ngarkuara dhe të marra përsipër.

**Neni 11
Humbja e cilësisë së anëtarit**

11.1 Anëtari i Liga Unike, pushon automatikisht së qeni si i tillë, kur :

- a) Heq dorë nga anëtarësia.
- b) Vdes ose humbet zotësinë për të vepruar.
- c) Dënohet penalisht nga organet e drejtësisë me heqje lirie.
- d) Përrjashtohet për shkak të cenimit të rëndë të dispozitave të statutit apo interesave të Ligës Unike.
- e) Ndikon në përkeqësimin e imazhit të shoqatës dhe pengon zbatimin e programeve /projekteve që aplikon Liga.

11.2 Kompetenca për përjashtimin e anëtarit nga Liga Unike i takon Bordit Drejtues, i cili nxjerr një vendim të arsyetuar bazuar në pikat e mësipërme.

**KREU III
ORGANET DREJTUESE TË
LIGA UNIKE**

**Neni 11
Organizimi i Ligës Unike**

Liga Unike organizohet në baza vullnetare. Organet drejtuese të Ligës Unike janë:

- a) Federatat themeluese të Ligës Unike;

-
- b) Bordi Drejtues;
 - c) Kryetari;
 - d) Drejtori Ekzekutiv i Ligës Unike.

Neni 12 Bordi Drejtues i Ligës Unike

- 12.1 Liga Unike mbikëqyret dhe udhëhiqet nga Bordi Drejtues, në të cilin të gjitha federatat pjesëmarrëse i delegojnë nga 2 përfaqësues, ndërsa përfaqësuesit e federatave në këtë Bord e emërojnë unanimisht anëtarin e pavarur të Bordit, i cili do të shërbejë edhe si Kryetar i Bordit të Ligës Unike.
- 12.2 Bordi zgjidhet me mandat të plotë dy (2) vjeçar.
- 12.3 Bordi është organi më i lartë ekzekutiv i Ligës, i cili udhëheq me punën e Ligës. Bordi Drejtues për punën e vet i përgjigjet Federatave themeluese të Ligës.
- 12.4 Mënyra dhe procedurat e punës së Bordit Drejtues përcaktohen me Rregulloren e Punës së Bordit Drejtues të Ligës Unike.

Neni 13 Kryetari

- 13.1 Kryetari i Bordit Drejtues është përfaqësuesi më i lartë i Ligës;
- 13.2 Kryetari e drejton Bordin Drejtues dhe është përfaqësues ligjor i Ligës Unike në marrëdhënie me të tretët.

Neni 14 Kompetencat e Kryetarit

Kryetari ka këto kompetenca:

- a) Thërret dhe drejton mbledhjet e Bordit Drejtues.
- b) Ka të drejtë të marrë përsipër të drejta dhe detyrime në emër të Ligës Unike.
- c) Të hap llogari bankare dhe të urdhëroj llogaritë bankare të Ligës duke pasur të drejtë të kryej çdo lloj transaksioni, tërheqje dhe derdhje në emër dhe për llogari të Ligës në përmbushje të interesave të ligjshme.
- d) Të përfaqësojë ligjërisht Ligën në marrëdhënie me të tretët. Kryetari ka të drejtën ekskluzive për nënshkrimin e marrëveshjeve, kontratave, dhe autorizimeve për të vepruar në emër dhe për llogari të Ligës. Në raste të veçanta mund të autorizojë Drejtorin Ekzekutiv për të kryer veprime në emër të Ligës në mungesë të tij.
- e) Të kontrollojë administrimin e mjeteve financiare dhe pasurinë e Ligës.
- f) Kontrollon përdorimin e fondeve, transferimi i të cilave mund të bëhet vetëm me firmën e Kryetarit, ose të personave të autorizuar prej tij.
- g) Raporton para Bordit Drejtues të Ligës Unike.

Neni 15 Mandati i Kryetarit

15.1. Kryetari zgjidhet nga Bordi Drejtues me mandat dy vjeçar.

Neni 16 Kompetencat dhe detyrat e Drejtorit Ekzekutiv

16.1 Drejtorin Ekzekutiv të Ligës Unike e emëron Bordi Drejtues për një mandat dy (2) vjeçar me mundësi të riemërimit për një mandat shtesë. Drejtori Ekzekutiv themelon marrëdhënie pune me Ligën Unike me afat të caktuar prej dy (2) vitesh, në bazë të ligjit të zbatueshëm të punës në Kosovë.

16.2 Drejtori Ekzekutiv mund të shkarkohet nga Bordi Drejtues edhe para skadimit të mandatit të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, në rast se Bordi Drejtues konstaton se i njëjti ka kryer shkelje ligjore, të këtij Statuti apo akteve tjera normative të Ligës.

16.3 Kriteret, kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të emërimit dhe shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv i përcakton Bordi Drejtues në Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Ligës Unike.

Drejtori Ekzekutiv mes tjerash, kryen detyrat në vijim:

- a. Përfaqëson Ligën Unike, në bazë të autorizimeve të Bordit Drejtues dhe Kryetarit të Ligës;
- b. Është urdhërdhënës për realizimin e planit financiar;
- c. Udhëheq dhe është përgjegjës për punën e zyrës së Ligës.
- d. Kujdeset dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e punës në Ligë.
- e. Kujdeset për ekzekutimin e vendimeve dhe konkluzioneve të Bordit Drejtues dhe trupave punuese.
- f. Përgatit materialet për mbledhjet e Bordit Drejtues, nën mbikëqyrjen e Kryetarit.
- g. Kryen detyra tjera me të cilat e ngarkon Bordi Drejtues.
- i. I propozon Bordit formimin e trupave punuese.
- j. Realizon bashkëpunimin me FIBA, Federatat e Basketbollit dhe organizatat e tjera sportive jashtë Kosovës e Shqipërisë.
- k. Realizon bashkëpunimin me organizatat e tjera sportive të Kosovës dhe Shqipërisë.
- l. Merr pjesë në të gjitha mbledhjet e organeve dhe trupave punuese të Bordit Drejtues në cilësinë e këshillëdhënësit.
- m. Mbanë kontakte me mjetet e informimit.

-
- n. Ndhmon në hartimin e rregulloreve dhe akteve normative që miratohen nga Bordi Drejtues.
 - o. I propozon Bordit Drejtues profilin e bashkëpunëtorëve administrativo-profesional.
 - p. Interpreton aktet normative të Ligës që miratohen nga Bordi Drejtues.
 - q. Siguron përkrahje profesionale dhe administrative për Bordin dhe organet tjera të Ligës, sipas nevojës.
2. Kryen edhe punë të tjera të cilat dalin nga aktet normative të Ligës, apo të cilat i delegohen nga Bordi Drejtues.

Neni 17

Këshilli Mbikëqyrës i Ligës Unike

1. Liga Unike mbikëqyret nga Kryetarët e Federatave anëtare të Ligës Unike, të cilët e përbëjnë Këshillin Mbikëqyrës të Ligës.
2. Bordi Drejtues i Ligës Unike, Zyra Ekzekutive dhe të gjitha trupat punuese të tyre janë të obliguara që Këshillit Mbikëqyrës t'ia mundësojnë mbikëqyrjen e punës së tyre.
3. Këshilli Mbikëqyrës e përcjell ligjshmërinë e punës së Bordit Drejtues dhe trupave punuese dhe mbikëqyrë afarizmin financiar të Ligës Unike.

Neni 18

Zyra Ekzekutive e Ligës Unike

1. Liga Unike mund të themelojë marrëdhënie të punës në afat të caktuar me punëtorët të cilët do të punojnë dhe kryejnë shërbime profesionale, administrative dhe financiare për ligën.
2. Punësimi i punonjësve, lartësia e pagave të tyre dhe modalitetet dhe përgjegjësitë e punonjësve të Ligës do të përcaktohen me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Ligës Unike, e cila duhet të përgatitet nga Drejtori Ekzekutiv i Ligës Unike dhe të miratohet nga Bordi Drejtues.

KREU IV FINANCAT DHE ADMINISTRIMI I “LIGA UNIKE”

Neni 19

Pasuria, Burimet e financimit, mjetet (fondet)

19.1 Liga Unike ka pavarësi financiare. Burimet e saj financiare sigurohen nga:

-
- a) Federatat themeluese të Ligës.
 - b) Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës.
 - c) Transferta nga sponsorizime dhe grante të personave juridikë e fizikë, vendas ose të huaj, private ose publike.
 - d) Dhurime të ofruara nga subjekte private ose publike vendase apo të huaja.
 - e) Aktivitete dhe shërbime.
 - f) Të ardhura të tjera, të llojeve të ndryshme që mund të vijnë nga burime të tjera të ligjshme përfshirë të ardhurat neto që krijohen nga një aktivitet ekonomik.
 - g) Të drejtat e pronësisë, të drejta televizive, marketingu, shitje biletash, produktesh sportive, lotari sportive, shorte apo turne sportive etj.
 - h) Donacionet në të holla, dhuratat dhe letrat me vlerë,
 - i) Kontributet në mall.
 - j) Trashëgimitë.
 - k) Anëtarësinë.
 - l) Grantet.
 - m) Pasurinë e tundshme dhe e patundshme.
 - n) Të ardhurat e fituara përmes çfarëdo aktivitetesh të ligjshme të Ligës Unike me pasurinë dhe mjetet e saja.
- 19.2 Burimet e financimit shërbejnë vetëm për të arritur qëllimin e shoqatës dhe çdo e ardhur e përfituar do të shpenzohen duke i rinvestuar vetëm për arritjen e qëllimit të Ligës.
- 19.3 Të ardhurat e përfituara do të përdoren për të mbuluar koston e aktiviteteve, të gjitha llojet e detyrimeve të ligjshme që mund të ketë Liga si dhe për të krijuar një kapital (fond) të saj.
- 19.4 Liga Unike mund të angazhohet në aktivitete ekonomike me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të saja jofitimprurëse, me kusht që të ardhurat e realizuara nëpërmjet të aktiviteteve ekonomike të shfrytëzohen ekskluzivisht për të arritur qëllimet e theksuara në statutin e saj.

Neni 20

Gjatësia e ushtrimit të aktivitetit financiar

Viti ushtrimor i Ligës Unike fillon nga 1 Janari deri në 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik.

Neni 21

Mbajtja e kontabilitetit dhe auditimi

1. Liga Unike mban kontabilitetin sipas legjislacionit në Kosovë, në fuqi, nga financieri i emëruar nga Bordi Drejtues.
2. Auditimi financiar kryhet nga ekspert kontabël të licencuar të cilët caktohen nga Bordi Drejtues.

Neni 22

Mbyllja e bilancit financiar

Në fund të çdo viti, finansiari i ngarkuar nga Bordi Drejtues i Ligës Unike bën mbylljen e inventarit dhe të bilancit financiar. Bilanci përfundimtar duhet të pasqyrojë qartësisht, për kapituj të veçantë, drejtimin ekonomik – financiar të Ligës.

Neni 23

Ndalimi i shpërndarjes së fitimit

Liga Unike nuk mund t'ia shpërndajë te ardhurat, përfshirë ato neto nga një aktivitet ekonomik, asetet apo kapitalin e akumuluar asnjë personi. Ato përdoren vetëm për te mbështetur qëllimet jofitimprurëse të Ligës dhe nuk duhen përdorur asnjëherë për te siguruar përfitime direkte dhe/ose indirekte për asnjë nga themeluesit, Kryetarin apo anëtarët e Bordit Drejtues. Ky ndalim nuk përjashton pagesën e arsyeshme që mund t'u bëhet personave që punojnë për Ligën Unike.

Neni 24

Konflikti i interesave dhe detyrimi në lojalitet

1. Asnjë anëtar i organit drejtues nuk i lejohet të marrë pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje ku ai ka interes direkt apo indirekt ekonomik. Anëtar i Bordit Drejtues konsiderohet se ka interes ekonomik nëse ai/ajo, ose cilido anëtar i familjes së tij ka interes direkt apo indirekt ekonomik.
2. Çdo transaksion ndërmjet Ligës Unike dhe një organizate tjetër të ndërlidhur, apo ndërmjet shoqatës dhe anëtarëve, zyrtarëve, anëtarëve të Ligës ose punonjësve të saj ndalohet, përveç, nëse Bordi Drejtues vendos. Pas hetimeve të arsyeshme, se transaksioni është në interes, i drejtë dhe i arsyeshëm për shoqatën dhe se shoqata nuk kishte mundur të sigurojë marrëveshje më të favorshme me përpjekje të arsyeshme dhe brenda rrethanave ekzistuese.
3. Zyrtarët dhe anëtarët e Bordit Drejtues të Ligës e kanë detyrë që të tregojnë lojalitet, të mbrojnë fshehtësinë e informatave jopublike të Ligës dhe interesat e saj, si dhe të ushtrojnë përgjegjësitë e shoqatës me mirëbesim dhe kujdes.

Neni 25

Ndalime të veçanta

1. Liga Unike nuk pranon dhurata dhe nuk aplikon për fonde tek persona juridikë a fizikë, vendas ose të huaj te cilët shkelin hapur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut apo kryejnë ndonjë aktivitet, veprimtaria e të cilave nuk përkon me rendin juridik në Republikën e Kosovës dhe të drejtën ndërkombëtare duke cenuar dispozitat e këtij statuti.
2. Liga Unike nuk mund të angazhohet në mbledhje fondesh ose në fushata për të mbështetur partitë politike ose kandidatët për funksione politike dhe as nuk mund të propozojnë, regjistrojnë ose në ndonjë mënyrë të mbështesin kandidatët për poste publike.

KREU V MBARIMI I LIGA UNIKE

Neni 26 Transformimi dhe bashkimi i Ligës Unike

Transformimi i Ligës Unike ose bashkimi i saj me shoqata të tjera për përfitimin reciprok të tyre mund të vendoset vetëm nga Bordi Drejtues i Liga Unike dhe me miratimin e Federatave themeluese të saj.

Neni 27 Shpërndarja e “Liga Unike”

Shpërndarja e Ligës Unike bëhet kur:

- a) Bordi Drejtues me miratimin edhe të dy Federatave themeluese të saj vendos për mbylljen e aktivitetit të Ligës Unike.
- b) Bordi Drejtues me miratimin edhe të dy Federatave themeluese të saj konstaton se qëllimi i Ligës është përmbushur ose nuk ka mundësi të përmbushet.
- c) Veprimtaria e Ligës rezulton në kundërshtim me qëllimin e themelimit të saj;
- d) Vërtetohet se Liga ka filluar të ushtrojë veprimtari të kundërligjshme.
- e) Në çdo rast tjetër të parashikuar me ligj.

Vendimi për shpërndarjen e Ligës Unike merret nga Bordi Drejtues me miratimin edhe të dy Federatave themeluese të saj.

Neni 28 Likuidimi

Kur vendoset shpërndarja e Ligës Unike, ajo çregjistrohet, pushon veprimtarinë e saj dhe vihet në likuidim nga komisioni i likuidimit, i cili formohet dhe vepron në bazë të ligjeve në fuqi. E gjithë pasuria e Ligës i shpërndahet shoqatave të tjera që janë përfshirë në aktivitetet e saj.

KREU VI DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 29

Për çështjet e tjera të cilat nuk janë paraparë me këtë Statut do të normat e legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

Organet e Ligës Unike janë të obliguara t’i miratojnë dhe harmonizojnë aktet normative përkatëse me këtë Statut në afatin prej më së largu 90 ditë nga dita e aprovimit të këtij Statuti.

Neni 30

Ky Statut hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi Drejtues i Liga Unike.

Neni 31

Interpretimin zyrtar të këtij Statuti e bënë Bordi Drejtues i Liga Unike.

Në emër të Bordit Drejtues

Ilir TREBICKA

Kryetar

Liga UNIKE

10.09.2020, Tiranë